

Transparencë

Transparencë

Tema: Depozitat

Çka duhet të dini për një bankë, para se t'i afatizoni paratë Tuaja!

ProCredit Banka përpiqet për transparencë dhe objektivitet më të madh në komunikimin me klientët dhe prezantimin e prodhimeve. Klientët janë në fokusin e vëmendjes tonë dhe kanë të drejtë të kenë edukim cilësor financiar.

Kush janë pronarët e Bankës?

Informohuni për strukturën aksionare të bankës, për reputacionin e tyre dhe stabilitetin.

Pse duhet të di?

Ky është tregues për sigurinë e bankës dhe është e rëndësishme që pas saj të qëndrojnë dhe të vendosin institucione me renome.

Ku mund ta gjej këtë të dhënë?

Informohuni nëpërmjet të punësuarve në Bankë, ueb faqes zyrtare ose burimeve të dokumentuara si raporti vjetor, broshurat etj.

A posedon Banka vlerësim për famë nga agjenci me renome dhe të pavarura?

Pse duhet të di?

Ekzistojnë agjenci të cilat japin mendime të pavarura për stabilitetin e bankës dhe bëjnë analiza sipas kualitetit të punës kredituese dhe depozituese, duke analizuar:

- a) a bën banka analizë të mirë të kredisë;
- b) a u jep kredi banka atyre subjekteve që mund ta kthejnë kredinë. Mbi bazën e këtyre të dhënave, agjencia jep vlerësim dhe e përcakton famën dhe shkallën e sigurisë ose rrezikun e Bankës.

Ku mund ta gjej këtë të dhënë?

Informohuni nëpërmjet të punësuarve, nëpërmjet ueb faqes zyrtare, ose nëpërmjet ueb faqes së ndonjërës nga agjencitë për vlerësimin e famës.

Si i investon Banka mjetet nga depozitat e qytetarëve?

- a) a ofron prodhime kredie dhe kujt?
- b) sa është shkalla e kredive të cilat janë të vonuara me pagesën e kredive dhe shkalla e kredive të shlyera?

Çka duhet të di?

Bankat i investojnë mjetet e depozitave të qytetarëve në kredi për qytetarë dhe/ose ndërmarrje. Për atë se a i investon si duhet dhe sigurt mjetet, duhet të dihet e njëjta a krediton mbi bazën e analizës kualitative dhe të përpiktë financiare të kredikërkuësve. Mendohet se rreziku për mjetet e qytetarëve është minimal, nëse përqindja e kredive të cilat janë në vonesë me pagesën është nën 3%.*

**sipas praktikës botërore*

Ku mund ta gjej këtë të dhënë?

Këta të dhëna gjenden në raportet mujore të cilat Banka i dorëzon pranë Bankës Popullore të RM dhe në raportin vjetor.

Sa kamatë fitoni në të vërtetë?

Përse ka nevojë ta di?

Shkallët e kamatës shprehen në nivel vjetor. Gjatë kësaj llogarinë për atë se sa kamatë do të fitoni për periudhën e afatizimit, mund ta bëni edhe vetë edhe atë në mënyrën vijuese:

a) cila është në fakt kamata për një muaj?

Kamata për një vit e ndarë me 12 muaj = kamata për një muaj.

Shembull:

Dua të afatizoj 1.000 euro për 3 muaj (prill, maj, qershor) ndërsa Banka më thotë se shkalla e kamatës është 3,5% për një vit.

$$\text{Llogaris kështu: } \left(\frac{1000 \times 3,5 \times 91 \text{ ditë}}{365} \right) : 100 = 8,72 \text{ €}$$

b) Sa kamatë fitoj pas kalimit të periudhës?

Shumën të cilën dua ta afatizoj e shumëzuar me shkallën e kamatës në nivel vjetor e shumëzuar me periudhën e afatizimit në ditë e ndarë me numrin e ditëve të vitit kalendarik

Shembull:

Dua të afatizoj 1.000 euro për 12 muaj (1 vit) dhe shkalla e kamatës është 3,5 % për një vit

$$\text{Llogaris kështu: } \frac{1.000 \times 3,5 \times 365}{365 \times 100} = 35 \text{ €}$$

A është shkalla e kamatës e fiksuar dhe a e mban të drejtën Banka ta ndryshojë shkallën e kamatës gjatë periudhës së afatizimit, pas lidhjes së marrëveshjes me klientin?

Pse duhet të di?

Shkalla e kamatës duhet të jetë e fiksuar dhe e pandryshuar gjatë gjithë periudhës së afatizimit: prej momentit kur i keni afatizuar mjetet, deri në datën e fundit të periudhës së afatizimit.

Ku ta gjej këtë të dhënë?

Informohuni nëpërmjet të të punësuarve në bankë dhe lexojeni mirë marrëveshjen para se ta nënshkruani.

Gjatë kësaj, është mirë të informoheni edhe për këtë:

- a) a arkëton Banka provizion për hapjen dhe/ose mirëmbajtjen e depozitës?
- b) a mund ta prishni afatizimin e depozitës para kohe, çdoherë kur të keni nevojë?

Nëse përgjigja është po, atëherë:

- a llogaritet kamatë ndëshkuese për prishjen e marrëveshjes?
- a do të zvogëlohet gjatë kësaj depozita e juaj?